



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr.76/10
Prishtinë, më 24.03.2010, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Kosara Nikolić, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Besa Gaxheri, Suzana Novobërdaliu dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Gani Koci, Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Haki Shatri, dhe Mufera Sinik.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Hasan Preteni nga AKK, Naile Krasniqi nga KPM, Teki Shala, Alexander Beetz, Ramadan Islami nga GTZ, monitorues nga Zyra e presidentit, OSBE, NDI, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Kosara Nikolić, zëvendëskryetare dytë e komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më datë 3.03.2010;**
- 3. Shqyrtimi i Marrëveshjes nr. 03/3118/Do-1964 dt. 27.01.2010 për Kredi dhe Financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe KfW Frankfurt am Main;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/3316/Ra-02 vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009,**
I ftuar: Daut Demaku, Nënkryetar i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media;
- 5. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/3316/Ra-02 vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009,**
I ftuar: Hasan Preteni, Drejtor i AKK;
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare me raportin me amendamente të komisionit funksional - Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente;**

7. **Shqyrtimi i Projektligjit për Gazetën Zyrtare me raportin me amendamente të komisionit funksional -Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
8. **Informatë në lidhje me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndryshimin e tabelave buxhetore 3.2 dhe 4.2 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010;**
9. **Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës. Paraprakisht propozoi që rendi i ditës të plotësohet me një pikë të re, shqyrtimi i PL për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për TVSH dhe të jetë pika e dhjetë.

Armend Zemaj në mungesë të një pjese të anëtarëve të komisionit propozoi që të shqyrtohet vetëm pika e tretë dhe pika plotësuese që ka të bëjë me PL për TVSh-në, të tjerat të shtyhen për në mbledhjen e radhës. Bëri vërejtje për njoftimin e vonshëm të mbledhjes dhe me agjendën e ngarkuar. Duhet ndryshuar kjo praktikë.

Besa Gaxherri theksoi se për shkak të njoftimit dhe dërgimit të materialit me vonës për mbledhjen e komisionit, që tregon mosrespektimin e rregullorës së punës dhe si rezultat jemi të papërgatitur për shqyrtimin e kësaj agjenda të ngarkuar. Propozoi që rendi i ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit.

Myrvete Pantina gjithashtu shfaqti pakënaqësitë për njoftimin e vonuar për mbledhjen e komisionit dhe agjendën shumë të ngarkuar, dhe u pajtua me propozimet që të shtyhet mbledhja, me përjashtim të atyre që janë urgjente, e që mund ti kalojmë.

Hajdin Abazi, po ashtu iu bashkëngjiti pakënaqësive për ftesën e vonuar për mbledhje dhe kërkoi që administrata të jetë më e vëmendshme në këtë drejtim. Megjithatë kërkoi që pika e tretë të përfundohet pasi që është çështje urgjente. Nëse nuk mund të kalohet sot të caktohet mbledhja për nesër, sepse kemi të bëjmë me një çështje që është në interes të përgjithshëm.

Kryesuesja u pajtua me mendimet për njoftimin e vonuar të mbledhjes, por se pika e tretë mund të kalohet pasi që materiali është shpërndarë shumë më herët dhe është kërkesë urgjente që të kalohet në seancë plenare. Pikat tjera të shtyhen për në mbledhjen e radhës së komisionit. Nëse është nevoja do të them pikat kryesore të kësaj marrëveshje dhe ajo është në interes të të gjithëve, dhe se për këtë çështje nuk duhet ndarë në pozitë apo opozitë.

Xhevdet Neziraj theksoi se edhe nëse shtyhet nesër mund të kemi problem me kuorum. Pasi që nuk kemi dikë nga Qeveria për të bërë pyetje dhe marrë sqarime konkrete për pikën e tretë, propozoi që komision ta kalojë këtë çështje në seancë dhe atje të shqyrtohet dhe vendoset për atë.

Besa Gaxherri theksoi se do të abstenojë në propozimin që për pikën e tretë të rendit të ditës komisioni të jep rekomandimin që ajo të kalohet për shqyrtim në seancë plenare.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Pika dy dhe tre u shqyrtuan në këtë mbledhje, ndërsa pikat tjera shtyhen për në mbledhjen e radhës së komisionit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 3.03.2010

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më datë 3.03.2010, pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Marrëveshjes nr. 03/3118/Do-1964 dt. 27.01.2010 për Kredi dhe Financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe KfW Frankfurt am Main

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesja konstatoi se me gjashtë vota Për asnjë Kundër dhe një Abstenim (znj. Besa Gaxherri), Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

- I.** Marrëveshja për Kredi dhe Financim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe KfW Frankfurt am Main, procedohet për shqyrtim në seancën plenare të radhës të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisioneve

Kryesuesja e Komisionit

Kosara Nikolić
